



Shërbimi HomeNet TV

Udhëzues për Përdoruesit

Paralajmërim mbi sigurinë e përgjithshme



KUJDES!



KUJDES: për të ulur rrezikun e goditjes elektrike, mos e hap kapakun e dekoderit. Duhet të riparohet nga personeli i autorizuar për riparim.

Gjithmonë ndiqni këto udhëzime për të shmangur rrezikun e lëndimit tuaj ose dëmtimit të pajisjeve.

- Stakoni dekoderin nga priza AC para pastrimit.

Përdorni vetëm një copë të lagur për pastrimin e jashtëm të dekoderit.

Mos përdorni pajisje ose pjesë shtesë që nuk rekomandohen nga prodhuesi i dekoderit pasi ato mund t'i shkaktojnë probleme pajisjes.

- Mos e vendosni dekoderin në një platformë, standë, tripod, kllapë apo tavolinë të paqëndrueshme.

Mos lejoni rrëzimin e dekoderit, sepse ai mund t'i shkaktojë dëme serioze pajisjes.

- Mos bllokoni apo mbuloni pjesët e hapura në dekoder (këto për arsye të ajrimit dhe tejnxehjes).

- Instaloni dekoderin tuaj në një hapësirë të thatë me ajërim, larg nga dielli, shiu dhe pluhuri; larg nga burime të nxehtësisë, ngrohësit elektrikë / me gaz apo objektet me flakë (qirinj, llampa me vajguri, etj).

Mos e vendosni dekoderin në vende të mbyllura, si për shembull, dollapë apo sirtarë, pa ajërosjen e duhur.

Mos e vendosni dekoderin mbi ose poshtë pajisjeve të tjera eketronike.

- Dekoderi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimit ose spërkatjes nga substancat e lëngshme.


Përdorni dekoderin duke përdorur vetëm kordonin e furnizimit me energji elektrike që e ka vetë dekoderi.

- Stakoni kordonin elektrik të dekoderit duke e hequr nga spina, por jo duke hequr kordonin.

- Sigurohuni që kordoni i furnizimit me energji elektrike nuk është i ekspozuar ndaj shkeljes apo shtypjes nga një objekt i vendosur sipër ose kundrejt saj.
 - Mos e mbani dekoderin në vende të tilla si:
 - aty ku është shumë nxehtë ose ftohtë,
 - aty ku ka shumë lagështirë,
 - aty ku ka tejkallim temperature, për shembull, përballë kondicionerit apo ventilatorëve ngrohës.
 - aty ku ka pluhur ose hi, në zona të kufizuara, ku nxehtësia nuk mund të çlirohet.
 - aty ku ekspozohet direkt ndaj rrezeve të diellit.
 - Për mbrojtjen shtesë gjatë një stuhie me rrufe, ose kur dekoderi nuk është lidhur dhe nuk është përdorur për periudha të gjata kohore, hiqeni atë nga priza e murit dhe shkëpusni linjat ndërmjet dekoderit dhe antenës. Kjo do të sigurojë një mbrojtje kundrejt dëmtimit elektrik të shkaktuar nga rrufeja.
-


Asnjëherë mos tentoni ta riparoni vetë dekoderin. Asnjëherë mos e hapni ose hiqni kapakun e dekoderit! Ju rrezikoni ekspozimin tuaj ndaj goditjeve elektrike dhe lëndimit. Të gjitha riparimet duhet të kryhen nga një personel i autorizuar shërbimi.

Instalimi




1) **USB**

Lidh pajisjen USB memory me portën USB.




1) **AV Out**

2) **Reset** (Rivendos)



DC 12V

Lidhja me energji
elektrike connection



1) S/PDIF

Lidh një dalje digjitale përforcuese.

2) HDMI

Lidh dekoderin tek një HDTV set me një kablo HDMI.



3) ETHERNET

Lidh kabllo LAN tek porta Ethernet.



4) DC J 2V IN

Për lidhjen e dekoderit me burimin kryesor të energjisë.


Lidhja




Sistemi audio




Pajisjet shtesë të përfshira




Kordon



Kablllo HDMI



Telekomanda



Bateritë

Specifikimet

Çipset	Broadcom / BCM7584
Memorja	4MB NOR, 512MB NAND
Programi DRAM	1GB DDR3
Memorja e shtuar	USB / IP (Automatik/manual)
Kodek	<ul style="list-style-type: none">• Video- MPEG-2, MPEG-4/H.264/AV C- Dual 1080i decode ose 1080p60 decode • Audio- MPEG Audio
Ekrani përpara	<ul style="list-style-type: none">• 1 LED- Energjia (Ndezur: Jeshile / Fikur: E kuqe)
Lidhëzit prapa	<ul style="list-style-type: none">• HDMI 1.4 a• RJ45• S/PDIF (Optike)
Përmasat	<ul style="list-style-type: none">• Përmasa (Gjerësi*Thellësi*Lartësi) 110mm(GJ)x110(Th)mmx26(L)mm



Udhëzues mbi Përdorimin e Telekomandës

Paraqitja e Telekomandës




Specifikimet

- | | | |
|----|------------------------------------|---|
| 1 | Standby | Butoni për alternimin ndërmjet vënies në funksion dhe gatishmërisë. |
| 2 | Mute | Butoni për aktivizimin ose mosaktivizimin e audios. |
| 3 | Butonat e numrave | Butonat e numrave për përzgjedhjen e kanalit, ndryshimin e kanalit dhe futjen e kodit PIN. |
| 4 | Kërkimi | Butoni i kërkimit. |
| 5 | PIP | Figurë mbi figurë. |
| 6 | Guidë | Butoni i udhëzimit që aktivizon udhëzimin e programit (EPG) në ekran. |
| 7 | Menu | Butoni i MENUSË për shfaqjen e Menusë Kryesore në ekran ose kthimin në menunë e mëparëshme. |
| 8 | i | Butoni i shfaq kutinë e informacionit në pamjen normale të ekranit. |
| 9 | Shigjetat lart e poshtë | Butoni i lëvizjes poshtë dhe sipër në menu. |
| 10 | Shigjetat majtas e djathtas | Butoni i lëvizjes majtas dhe djathtas në menu. |
| 11 | OK | Butoni i konfirmimit të selektimit tuaj. |
| 12 | V +/- | Butoni i ngritjes dhe uljes së zërit. |
| 13 | CH lart e poshtë | Butoni i përzgjedhjes së Kanaleve lart/poshtë. |
| 14 | Back | Kthehu pas. |
| 15 | Exit | Butoni i daljes nga programi. |
| 16 | OPT | Për të kaluar në video, kalojeni aparaturën në modalitetin kërkimor Search Setup. |
| 17 | Butoni i kuq | Butoni i kuq |

18	Butoni jeshil	Butoni jeshil
19	Butoni i verdhë	Butoni i verdhë
20	Butoni blu	Butoni blu
21	Record	Butoni i regjistrimit ruan kanalin aktual në HDD të jashtëm.
22	Pause	Butoni i pauzës, i përdorur për ndalimin e skedarit.
23	Stop	Butoni i ndalimit të regjistrimit ose programit.
24	REW	Butoni i kthimit mbrapa.
25	Play	Butoni i përdorur për luajtjen e skedarit.
26	FF	Butoni i përshpejtitimit përpara.
27	Pre file	Butoni i luajtjes së para-skedarit në PVR.
28	Aspect	Aspekti i figurës.
29	Next File	Butoni i luajtje së skedarit tjetër në PVR.
30	Audio	Butoni i përzgjedhjes së modalitetit të zërit. (Mono, Majtas, Djathtas, Stereo)
31	SUB-T	Butoni që mundëson ose pamundëson titrat ose ndryshimin e modalitetit të listës së kanaleve.

Bateritë



Informacion i rëndësishëm mbi përdorimin e baterive:

- Mos përzieni lloje të ndryshme baterish, ose bateri të vjetra me të reja.
- Mos përdorni bateri të rikarikueshme për telekomandën.
- Hiqini bateritë nga telekomanda nëse nuk do ta përdorni për disa javë, për të shmangur riskun e rrjedhjes.
- Ju lutemi të respektoni mjedisin tuaj dhe rregulloret lokale për hedhjen e baterive në mënyrë të përgjegjshme.



Mos provoni të rikarikoni bateritë.
Hiqni menjëherë ndonjë bateri që rrjedh.
Tregoni kujdes me bateritë që rrjedhin sepse ato mund t'ju shkaktojnë dëgjie të lëkurës ose syve, ose dëmtime të tjera fizike.

Funksionimi

- Kjo telekomandë funksionon vetëm për funksionet e dekoderit.
- Funksioni i saktë i butonit do të varet nga ofruesi juaj i shërbimit.
- Kur të shtypni një buton të telekomandës, drejtojeni telekomandën përballë dekoderit për të siguruar funksionimin e duhur.
- Mos e mbuloni dritaren IR në pjesën e përparme të telekomandës.
- Kur të shtypet një buton i telekomandës, do të ndizet butoni standby i dekoderit.

HDMI

Termet HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe HDMI Logo janë marka tregtare apo marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe shtete të tjera.

1one
për ty.